

Emri i Lëndës : E Folura në Publik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 304	C	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Irena Myzeqari, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Gjatë gjithë historisë së njerëzimit njerëzit e kanë përdorur të folurin në publik si një mënyrë vitale komunikimi. Të folurit në publik është një mënyrë e bërjes publike të ideve; e ndarjes së këtyre ideve me njerëzit e tjerë dhe një mënyrë e ndikimit të individëve. Në kurs do të flitet për artin e të folurit në publik dhe do të analizohen të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe mbajtjen e një fjalimi të mirë para publikut. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimi të tillë. Analiza e audiencës, puna kërkimore paraprake, zgjedhja e temës, hartimi i fjalimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e etheve të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtojmë së bashku.					
Objektivat		Në fund të kësaj lënde, studenti do të jetë i familjarizuar me paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse. Për të bërë këtë, do të përqendrohet në disa aspekte si: Çfarë do të thotë të jesh një folës dhe dëgjues etik i mesazheve? Identifikimi i elementeve qëndrorë për një mesazh logjik dhe të mirëorganizuar; Identifikimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të ligjëratave etj					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në artin e të folurit në publik;Tradita e folurit në publik; Ngjashmëritë dhe dallimet midis të folurit në publik dhe bisedimit- Të folurit publik dhe mendimi kritik.						
2	Analiza e audiencës; Fokusimi te audience; Psikologjia e audiencës; Analiza demografike e audiencës; Analiza e audiencës sipas situatës; Marrja e informacioneve mbi audiencën						
3	Zgjedhja e një teme dhe qëllimi; Zgjedhja e një teme; Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm dhe specifik; Formulimi i idesë kryesore						
4	Etika dhe të folurit në publik; Rëndësia e etikës; Këshilla për të folurit etik; Plagjiatura; Këshilla për dëgjimin etik Dëgjimi; Dëgjimi dhe të menduarit kritik; Shkaqet e dëgjimit të dobët						
5	Mbledhja e materialeve; Përdorimi i njohurive dhe i përvojave vetjake; Kërkimi në bibliotekë; Kërkimi në internet; Intervista; Këshilla për punën kërkimore						
6	Organizimi i pjesës kryesore të fjalimit- Pikat kryesore- Materialet mbështetëse						
7	Fillimi dhe fundi i fjalimit; Hyrja; Konkluzioni; Skicimi i fjalimit; Skica e përgatitjes; Skica e mbajtjes së fjalimit						
8	Përdorimi i gjuhës; Kuptimi i fjalëve; Përdorimi i saktë dhe i qartë i fjalëve; Përdorimi i përshtatëshëm i gjuhës						
9	Mbajtja e fjalimit; Metodat e mbajtjes së fjalimit; Zëri i folësit; Trupi i folësit						
10	Përdorimi i mjeteve ndihmëse pamore; Llojet e mjeteve ndihmëse pamore; Përdorimi i Power Point-it						
11	Llojet e fjalimeve; Të flasësh për të informuar; Të flasësh për të bindur						

12	Metodat e bindjes; Ndërtimi i besueshmërisë; Përdorimi i evidencës; Arsyetimi; Tërheqja emocionale (patosi)
13	Fjalimet për raste të veçanta; Fjalime prezantuese; Fjalime dorëzimi të një vlerësimi publik; Fjalime pranimi të një vlerësimi publik; Fjalime përkujtimore; Fjalimet e pasdarkave
14	Fjalimet në grupe të vogla; Çfarë është një grup i vogël?; Udhëheqja dhe përgjësiti në grupe të vogla; Metodat e mendimit reflektues; Prezantimi i mendimeve të grupit
15	Përsëritje, prezantim i projekteve studentore
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Lucas E., Stephen; Arti i të folurit në publik, UET Press, Tirana, 2011 • Vehbiu, Ardian; Shqipja totalitare – Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990; Botimet Çabej; Tirana 2007	
Referenca të tjera	
• Sprague, Jo; Stuart, Douglas; The speaker's compact handbook; Wadsworth Centage Learning, 2010 • Public Speaking and presentations; The MC-Graw - Hill Companies; 2010	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse.
2	Studentët do të zhvillojnë mendimin kritik mbi perceptimin e mesazhit të shpërndarë dhe analizimin e audiencës para dhe pas ligjërimit publik
3	Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë elementët qendrorë për një mesazh logjik

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	33	33
Provimi final	1	40	40
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			149
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.96
ECTS			6.00